

## Komuna e Lipjanit/Lipljan

### **Siniša (Vojislav) Blagojević**

(27.10.1966, serb nga Krajishta/Krajište, komuna e Lipjanit/Lipljan, pylltar)

Siniša punonte në ndërmarrjen publike *Srbijašume*. Ishte përgjegjës për vend gjuetinë e *Blinajës/Lipovica* në Blinajë/Lipovica. Jetonte me bashkëshorten dhe dy vajza në një banesë që i takonte Drejtorisë së Pyjeve. Kur pjesëtarët e UÇK-së e thyen dhe e bastisën banesën e tij, ai me familje kaluan më 19.06.1998 në Llapllasellë/Laplje Selo [Prishtinë/Priština]. Në datën **24.06.1998**, Siniša me traktorin zyrtar u nis për t'i transportuar derrat nga **Blinaja/Lipovica**. Nga ajo ditë, për fatin e tij nuk dihet asgjë. Një muaj më vonë, një komshiu i tij nga Krajishta/Krajište [identiteti i tij është i njohur për FDH] i ka treguar nënës së tij se Siniša ishte mirë, ishte duke i hapur istikamet për UÇK-në, e kosiste barin dhe i ushqente derrat. Zhdukja e tij është e evidentuar nga KNKK-ja në lëndën që e mban numrin rendor YUK-050006-01.

**Burimet:** deklarata T.D, FDH-29597; deklarata B, FDH-5510; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; AFPRRZHKeM, *Regjistri i të rrëmbyerve...*, FDH-17551; ICTY, IT-03-66 (F. Limaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 30.11.2005, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int\\_cid=119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi-\(-IT-03-66-\)](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi-(-IT-03-66-)).

### **Adem (Rexhep) Krasniqi**

(16.10.1953, shqiptar nga Zllakuqani/Zlokućane, komuna e Lipjanit/Lipljan, minator, gjashtë fëmijë)

Ademi e ka kaluar tërë jetën në Zllakuqan/

Zlokućane. Në datën **14.07.1998**, nga ora 16:00, Ademi me vëllain Ruzhdiun, kushëririn Ganiun dhe dy komshinjtë e tyre u nisën për në fshatin Leletiq/Laletić për t'i shprehur ngushëllimet një miku, të cilit i kishte vdekur i vëllai. Duke kaluar nëpër fshatin **Vërshec/Vrševce**, pjesëtarët e UÇK-së i ndalën dhe i legjitimuan. Pastaj, i lëshuan të kalonin. Në kthim, pjesëtarët e UÇK-së sërish e kanë ndaluar Ademin me të tjerë. Kësaj radhe, ata e ndaluan Ademin, ndërsa të tjerëve u urdhëruan që të vazhdonin rrugën. Nga ajo ditë, Ademi i është humbur çdo gjurmë dhe ende nuk dihet asgjë për fatin e tij. KNKK ka regjistruar zhdukjen e Ademit në lëndë, që është sistemuar me numrin rendor YUK-050120-01.

**Burimet:** deklarata M.K, FDH-11622; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

### **Musli (Ferat) Musliu**

(13.02.1933, shqiptar nga Belinca/Belince, komuna e Shtimes/Štimlje, bujk, katër fëmijë)

Musliu me bashkëshorten Zarifen, vajzën Myrveten dhe djemtë, Mujën dhe Ginerin, jetonin në Belincë/Belince. Djali i tretë i Musliut, Enveri, jetonte në Francë. Në datën 8.07.1998, pjesëtarët e UÇK-së e kanë çuar Mujën në shtabin e UÇK-së në **Kroimirë/Krajmrovce** [Lipjan/Lipljan] që ta merrnin në pyetje. Pasi që nuk u kthye për disa ditë rresht, Musliu shkoi më **17.07.1998** në Kroimirë/Krajmrovce për ta kërkuar të birin. Nga ajo ditë, familjarët e tij e kanë humbur çdo kontakt me Musliun. Gjashtë ditë më vonë, Muja u